



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	07.12	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
J.P. PRIZREN	8855/21		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.885/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.885/2021 të datës 25.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Fadil Ferati", Komuna e Prizrenit, kundër Vendimit me Nr.01-112-36544 të datës 09.03.2021 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.885/2021 e datës 25.10.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.01-112-36544 i datës 09.03.2021 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prizrenit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën „Zyrtar për Bashkëpunim me DKA, Prindër dhe Nxënës“, në kuadër të Drejtorisë për Arsimit dhe Shkencë, sipas plotësimit ndryshimit të Akt emërimit me numër Nr.01-112-154452 të datës 17.10.2018.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsy e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në pozitën “Zyrtar për bashkëpunim me DKA, prindër dhe nxënës”, sipas plotësimit ndryshimit të Akt emërimit me numër Nr.01-112-154452 të datës 17.10.2018 në Komunën e Prizrenit, me datën 09.03.2021 Kryetari i Komunës së Prizrenit ka nxjerrë vendimin me numër Nr.01-112-36544, për transferim të përkohshëm të ankuesit nga pozita “Zyrtar për bashkëpunim me DKA, Prindër dhe nxënës”, në kuadër të Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë, në pozitën “Zyrtar për vlerësimin e pronës së paluajtshme” në Drejtorinë Komonale për Buxhet dhe Financa-Sektorin e tatimit në pronë.

Ankuesi me datën 23.03.2021 parashtron ankesë me numër protokoll 1325/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore për kthim në vendin e punës dhe shfuqizimin e vendimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit të datës 09.03.2021, për transferimin e përkohshëm. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.05.2021, ka nxjerrë Vendimin me numër Anr.176/2021 me të cilin e refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit, duke e lënë në fuqi vendimin me numër Nr.01-112-36544 të datës 09.03.2021 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit lidhur me transferimin e përkohshëm të ankuesit.

Ankuesi, me datën 20.09.2021 dhe 25.10.2021, me kërkesë i ‘u është drejtuar Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, ku ka kërkuar që pas skadimit të transferit të përkohshëm të kthehet në pozitën ku ka qenë i sistemuar me herët.

Ankuesi i pakënaqur me mos përgjigje nga ana e Komunës së Prizrenit, lidhur me mos kthimin në pozitën e tij të mëparshme, pas skadimit të transferit të përkohshëm, me datën 25.10.2021 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:5161/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 01.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Prizrenit, ndërsa Komuna e Prizrenit me datën 22.11.2021 përmes Njesisë për Burime Njerëzore, ka përcjellë gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 25.10.2021 me Nr.Prot:5161/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e ankuesit me numër 02-112 Nr.146861 e datës 20.09.2021 e parashtruar për Menaxherin e burimeve njerëzore në komunën e Prizrenit; Vendim me numër A.nr.176/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër Nr.01-112-36544 i datës 09.03.2021 nga Kryetari i Komunës së Prizrenit për transferimin e ankuesit; Kërkesa me numër 01-112 Nr.166775 e datës 25.10.2021 e parashtruar nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Prizrenit dhe Menaxherin e burimeve njerëzore; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 26.11.2021 nga Komuna e Prizrenit me shkresat e bashkangjitura; Kërkesë për informata shtesë e datës 26.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresë zyrtare e datës 25.10.2021 me numër 01-112 Nr.166775; Kërkesë me numër 02-112 Nr.146861 e datës 20.09.2021 e parashtruar nga ankuesi për Menaxherin e burimeve njerëzore të Komunës së Prizrenit; Ankesë e ankuesit e

datës 23.03.2021 e parashtruar nga ankuesi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërim i ankuesit me numër Nr.01-112-10572 i datës 18.01.2018; Kërkesë e datës 26.11.2021 për prova shtesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja e datës 26.11.2021 dhe 30.11.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prizrenit .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të ofruara nga ankuesi, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prizrenit të datës 09.03.2021, ankuesi është transferuar përkohësisht nga pozita e "Zyrtarit për Bashkëpunim me DKA, Prindër dhe Nxënës", në pozitën "Zyrtar për vlerësimin e pronës së paluajtshme" në Drejtorinë komunale për Buxhet dhe Financa-Sektori i tatimit në pronë, për interes të institucionit, për shkak të mungesës së stafit, e si nevojë e domosdoshme që është paraqitur gjatë procesit të punës në këtë drejtori lidhur me përmbushjen e objektivave dhe obligimeve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se ankuesi e ka ushtruar pozitën „Zyrtar për vlerësimin e pronës së paluajtshme“, në Drejtorinë Komunale për Buxhet dhe Financa-Sektori i Tatimit në Pronë, për periudhën e paraparë sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, mirëpo që i njëjti pas përfundimit të afatit të transferimit nuk është kthyer në pozitën e mëparshme siç ka qenë sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës me numër Nr.01-112-154452 të datës 17.10.2018 në pozitën „Zyrtar për Bashkëpunim me DKA, Prindër dhe Nxënës“, në kuadër të Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë, e që është në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili në mënyrë decisive ka përcaktuar që: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”*, sepse me rastin e transferimit të nëpunësve civil kur është në interes të institucionit periudha kohore e transferimit brenda institucionit nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë (6) muaj brenda dy (2) viteve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar, se që nga data 09.09.2021, është plotësuar kushti i transferimit të përkohshëm për periudhën e caktuar edhe sipas Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ku ankuesi është dashur të kthehet në pozitën e mëparshme ,ku ka qenë i sistemuar para transferimit të përkohshëm sipas plotësim ndryshimit të Akt Emërimit të datës 17.10.2018 në pozitën "Zyrtar për Bashkëpunim me DKA, Prindër dhe Nxënës", në kuadër të Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë, ashtu siç përcaktohet edhe dhe nenin 4 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë : *“Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prizrenit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Prizrenit, janë të obliguar që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Zyrtar për Bashkëpunim me DKA-në, Prindër dhe

Nxënës", ne kuadër të Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit me numër Nr.01-112-154452 të datës 17.10.2018 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.885/2021

Ardita Perçuku-Shyti



Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.